

VENDIM
Nr. 646, datë 5.10.2022

**PËR PROCEDURAT, KRITERET DHE RREGULLAT PËR ZBATIMIN E
PROGRAMEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL NËPËRMJET MBËSHTETJES
FINANCIARE TË OFRUAR, SIPAS PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT, PËR
KURSET E FORMIMIT PROFESIONAL TË ORGANIZUARA NGA
INSTITUCIONET E FORMIMIT PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e procedurave, kriterëve dhe rregullave për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar, sipas procedurave të konkurrimit, për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, në përputhje me pikat 2 dhe 4, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Neni 2

1. Procedurat e konkurrimit të parashikuara në këtë vendim për ofrimin e mbështetjes financiare për kurset e formimit profesional, të organizuara nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, zbatohen nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (në vijim “AKPA”).

2. Ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive përcakton çdo vit programet e formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare.

KREU II
**RREGULLAT PËR KONKURRIMIN E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT
PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE**

Neni 3

1. Kurset e formimit profesional synojnë kualifikimin dhe rikualifikimin e punëkërkuësve, me qëllim përgatitjen për integrim të shpejtë në tregun e punës dhe kanë një kohëzgjatje nga 3 deri në 12 muaj.

2. Nga mbështetja financiare përfitojnë të gjithë punëkërkuësit, si më poshtë vijon:

a) Pjesëmarrësit punëkërkuës të papunë të regjistruar, sipas pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, financohen në masën 100%, por, në asnjë rast, më të lartë se 300 000 (treqind mijë) lekë të kostos së kursit të formimit profesional;

b) Çdo pjesëmarrës punëkërkuës, sipas pikave 13 dhe 15, të nenit 3, të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, financohet në vlerën 50% të kostos së kursit të formimit profesional, por, në asnjë rast, më të lartë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Për personat me aftësi të kufizuara, institucionit të formimit profesional, publik apo privat, i financohen elementet e përshtatjes së arsyeshme, për sa u përket programeve të veçanta të trajnimit, kurrikulës së përshtatur, në përputhje me shkallën dhe llojin e aftësisë së kufizuar, përgatitjen e instruktorëve për të ofruar trajnim të posaçëm për këtë kategori, deri në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë.

KREU III KRITERET PËR KONKURRIMIN E INSTITUCIONEVE TË FORMIMIT PROFESIONAL, PUBLIKE APO PRIVATE

Neni 4

1. Çdo institucion, sipas pikës 2, të nenit 12, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional”, që ofron kurse të formimit profesional, konkurren me anë të një kërkesë për të përfituar mbështetje financiare.

2. Kërkuesi plotëson në mënyrë kumulative kriteret e përgjithshme, si më poshtë vijon:

a) të ketë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë kombëtare ose ndërkombëtare në ofrimin e kurseve të formimit profesional;

b) të mos jetë në proces falimentimi ose likuidimi;

c) të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera;

ç) të ketë të paktën 100 kursantë të trajnuar dhe të certifikuar gjatë veprimtarisë së mëparshme të tij;

d) të zotërojë një faqe interneti aktive, ku të pasqyrojë të gjithë informacionin e nevojshëm për kursantët, si katalogun e kurseve të ofruara, mënyrën e aplikimit në kurs, datat dhe afatet e zhvillimit të kursit, kurrikulën e kompetencave të kursit dhe, sipas rastit, informacionin për skemën e mbështetjes financiare për kursantët dhe tarifatat përkatëse;

dh) të ketë lidhur marrëveshje me operatorë tregu për ofrimin e praktikave të punës për kursantët e certifikuar;

e) të ofrojë këshillim karriere;

ë) në rastin e personit fizik, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale. Për personat juridikë, të mos jetë i dënuar organi administrativ, aksionarët ose ortakët.

Neni 5

1. Kursi i formimit profesional, i ofruar nga institucioni i formimit profesional, publik apo privat, duhet të plotësojë kriteret teknike, si më poshtë vijon:

a) të jetë i bazuar në një program të njohur, sipas kuadrit ligjor në fuqi, për të cilin kërkuesi zotëron të drejtën e pronësisë, të përdorimit apo, sipas rastit, certifikatë ose licencë;

b) të përmbajë si kriter pranimi, të paktën dy nga tri kriteret, e mëposhtme:

i. një testim logjik;

ii. një testim teknik/praktik, në përputhje me programin e kursit që ndiqet;

iii. një intervistë me një instruktor ose ekspert të fushës specifike, për të cilën zhvillohet kursi;

c) të zhvillohet nga një ose më shumë instruktorë të cilët plotësojnë të paktën dy nga tri kriteret e mëposhtme:

i. të kenë formimin arsimor në fushën për të cilën do të trajnohen kursantët;

ii. të kenë përvojë profesionale në fushën për të cilën do të trajnohen kursantët, në përputhje me kriteret e licencimit për kursin përkatës;

iii. të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë në mësimdhënie ose ofrim trajnimesh në fushën, për të cilën do të ofrohet kursi.

2. Kërkuesi ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje partneriteti me ente shqiptare apo të huaja për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikën 2, të nenit 4, dhe në pikën 1, të nenit 5, të kreut III, të këtij vendimi.

KREU IV

PROCEDURAT E KONKURRIMIT PËR OFRIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE

Neni 6

1. AKPA-ja publikon çdo vit kalendarik thirrjen për ofrimin e mbështetjes financiare dhe mundësinë për konkurrim të subjekteve të interesuara, që plotësojnë kriteret në Buletinin e Njoftimeve Publike në faqen e internetit dhe në median sociale.

2. Thirrja për konkurrim e publikuar nga AKPA-ja përmban kriteret e përgjithshme, teknike dhe të posaçme, nëse ka të tilla, në varësi të programit të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive, kriteret e vlerësimit të kërkesave të dorëzuara, vlerën e mbështetjes financiare, procedurën e konkurimit, si dhe dokumentet për pjesëmarrjen në programin e mbështetjes financiare përmes këtij vendimi.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni për pjesëmarrjen e institucioneve të interesuara të formimit profesional në skemën e mbështetjes financiare dorëzohen nëpërmjet portalit *e-Albania*. Dokumentet që ngarkohen në portalin *e-Albania* janë, si më poshtë vijon:

- a) certifikata e regjistrimit të kërkuesit pranë organit shtetëror kompetent;
- b) dëshmia për gjendjen gjyqësore të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda personit juridik;
- c) dëshmia që kërkuesi nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- ç) vërtetimi i lëshuar nga institucioni tatimor përgjegjës për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- d) pasqyrat financiare të audituara në 3 (tre) vjetëve të fundit;
- dh) plani i detajuar i biznesit për 3 (tre) vjet;
- e) deklarimi për numrin maksimal të kursantëve, që kërkohet të mbështeten nëpërmjet skemës së mbështetjes financiare;
- ë) marrëveshja e partneritetit me entet shqiptare apo të huaja për mbështetjen e kurseve të formimit profesional, nëse ka;
- f) lista e instruktorëve dhe mënyra e angazhimit të tyre në kursin e formimit profesional, që do të ofrohet në kuadër të skemës së mbështetjes financiare;
- g) dëshmitë për kualifikimet/certifikimet/përvojën e çdo instruktori të angazhuar në kursin e formimit profesional, që do të përfshihet në mbështetjen financiare;
- gj) planin mësimor për çdo kurs, për të cilin kërkohet pranim në skemën e mbështetjes;
- h) kriteret e pranimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, të kursantëve në çdo kurs të formimit profesional, që do të jetë pjesë e mbështetjes financiare;
- i) listën e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e kursantëve, si: provime, sfida teknike apo projekte;
- j) mekanizmi i ngritur gjatë ose pas përfundimit të kursit të formimit profesional, për këshillimin e karrierës dhe marrëveshjet për ndërlidhjen e kursantëve me operatorët e tregut të punës;
- k) modeli i certifikatës që individi merr pas përfundimit me sukses të kursit të formimit profesional;
- l) vetëdeklarimi për numrin e kursantëve të certifikuar gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit dhe për shkallën/nivelin e punësimit;
- ll) tarifa e zbatueshme për secilin kurs, që do të ofrohet në kuadër të skemës së mbështetjes financiare.

4. Dokumentet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, në momentin e ngarkimit në portalin *e-Albania* duhet të jenë:

a) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë, në original ose të njësuara me origjinalin;

b) në rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj dhe të legalizuara ose të pajisura me vulë apostile, në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 7

1. Jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga paraqitja e kërkesave për pjesëmarrje, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKPA-së, ngrihet Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga 3 (tre) anëtarë, një prej të cilëve mban pozicionin e kryetarit të komisionit.

2. Anëtarët e komisionit duhet të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet eksperiencë pune në fushën e formimit profesional ose të punësimit.

3. Komisioni i Vlerësimit ushtron detyrat e mëposhtme:

a) Administron dhe vlerëson të gjitha kërkesat e dorëzuara nga subjektet e interesuara;

b) Kërkon informacion shtesë nga subjektet e interesuara, në rastin kur dokumentet e ngarkuara në portalin *e-Albania* nuk plotësojnë kriteret e dhëna në pikën 3, të nenit 6, të këtij kreu;

c) Plotëson raportin e vlerësimit për çdo kërkesë të dorëzuar, duke përcaktuar njëkohësisht numrin e pikëve për secilën prej tyre.

4. Subjekti kërkues kualifikohet për të përfituar mbështetje financiare, nëse kërkesa e dorëzuar prej tij vlerësohet me të paktën 70 pikë për metodologjinë e mëposhtme të vlerësimit:

a) Kapacitetet për ofrimin e kursit të formimit profesional, sipas kriterëve të përgjithshme dhe teknike, ku përfshihet përvoja, infrastruktura fizike, teknike, platforma dhe licencat, si dhe kapacitetet e stafit trajnues vlerësohen deri në 60 pikë;

b) Plani i biznesit vlerësohet deri në 20 pikë;

c) Mekanizmi i ngritur për këshillimin e karrierës dhe marrëveshjet për ndërlidhjen e kursantëve me tregun e punës vlerësohen deri në 20 pikë.

5. Vendimi për kualifikimin ose jo të kërkesave për mbështetje financiare bazohet në mesataren e pikëzimit individual të çdo kërkesë nga të tre anëtarët e Komisionit të Vlerësimit.

6. Komisioni i Vlerësimit në AKPA përpilon listën e institucioneve të formimit profesional, publike apo private, të kualifikuara bazuar në rezultatet e vlerësimit të kërkesave dhe njofton fituesin përmes postës elektronike. Lista e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të internetit të AKPA-së.

7. Ankimimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit për listën përfundimtare të institucioneve përfituesve të mbështetjes financiare nga subjektet e interesuara bëhet në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 8

1. Kërkesa për pjesëmarrje si kursant në kurset e formimit profesional, për të cilat ofrohet mbështetje financiare, sipas përcaktimeve të këtij vendimi, bëhet nga individë nëpërmjet llogarisë së tij në shërbimin përkatës në portalin *e-Albania*, pasi ka bërë regjistrimin si punëkërkues.

2. Zyra rajonale/vendore e punësimit bën verifikimin paraprak të përmbushjes së kriterëve të kërkesës, të përcaktuara në shpalljen e miratuar, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi, për punëkërkuesit dhe i referon tek institucionet e formimit profesional, publike apo private, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së kërkesës.

3. Institucionet e formimit profesional, publike apo private, përzgjedhin kursantët në bazë të kriterëve të pranimit të tyre, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 5, të këtij vendimi, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.

4. Struktura rajonale/vendore e punësimit, institucioni i formimit profesional, publik apo privat dhe çdo kursant pjesëmarrës lidh një marrëveshje trepalëshe, sipas formatit të caktuar në rregulloren, sipas pikës 1, të nenit 11, të këtij vendimi.

5. Disbursimi i financimit tek institucioni bëhet nga struktura rajonale/vendore e punësimit, në bazë të raportimit për ndjekjen e kursit të formimit profesional për secilin kursant, kërkesës për kalim fondesh, së bashku me konfirmimin që kursanti ka përmbyllur me sukses pjesën takuese të pagesës, në rastin kur aplikohet.

6. Kursanti ngarkohet me detyrimin e kthimit të mbështetjes financiare të përfituar, në rastet kur:

a) ndërpret pa shkak të arsyeshëm kursin e formimit profesional;

b) përjashtohet nga kursi i formimit profesional;

c) nuk përmbyll kursin e formimit profesional brenda afateve kohore të parashikuara.

7. Një punëkërkuës mund të marrë pjesë vetëm një herë në një kurs formimi profesional, që i përket një programi të miratuar, sipas pikës 2, të nenit 2, të këtij vendimi.

8. Institucioni i formimit profesional, publik apo privat, dërgon pranë strukturës rajonale/vendore të punësimit listën e kursantëve të certifikuar që vërteton përfundimin e kursit me sukses, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga shpërndarja e certifikatave.

Neni 9

1. Kursantët, të cilët përfitojnë nga ky vendim kanë detyrimin të qëndrojnë dhe të kërkojnë punë brenda Republikës së Shqipërisë, për një periudhë jo më pak se 2-vjeçare, menjëherë pas mbarimit të kursit, në të kundërt janë të detyruar të kthejnë 100% të vlerës së mbështetjes financiare të përfituar, sipas skemës së përcaktuar në këtë vendim.

2. Niveli i punësimit të të certifikuarve nga institucionet e formimit profesional, publike apo private, përfitues të mbështetjes financiare duhet të jetë jo më pak se 50% brenda 6 (gjashtë) muajve nga certifikimi. Në rast se niveli i punësimit është më pak nga parashikimi i dhënë më sipër, institucioni i formimit profesional publik apo privat fitues humb të drejtën e mbështetjes së mëtejshme në thirrjen pasardhëse për kursin e formimit profesional, për të cilin është dhënë mbështetja financiare.

3. Në rast se nuk përmbushet niveli i punësimit të kursantëve, sipas pikës 2 të këtij neni, nuk kthehet mbështetja financiare e përfituar.

4. Pranimi i kërkesave nga institucionet e formimit profesional, publik apo privat, bëhet brenda fondit të alokuar, sipas programit të miratuar, sipas pikës 2, të nenit 2, të këtij vendimi.

5. AKPA-ja nëpërmjet strukturave të saj monitoron institucionet publike apo private të formimit profesional gjatë zbatimit dhe në përfundim të kursit.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

1. AKPA-ja përgatit raportin vjetor të monitorimit, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse.

2. Vlerësimi i ndikimit të skemës së mbështetjes financiare bëhet çdo dy vjet nga struktura përgjegjëse pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe aftësive.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në programin “Tregu i punës”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Neni 11

1. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i AKPA-së për nxjerrjen e rregullores së detajuar, për mënyrën e zbatimit të këtij vendimi, duke përfshirë procedurën e monitorimit, formatin e marrëveshjes trepalëshe, në zbatim të pikës 4, të nenit 8, të këtij vendimi, si dhe thirrjen për konkurrim, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku